

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Edhe fundi e ka një erë...
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/edhe-fundi-e-ka-nje-ere-i588694
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 10:40:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 10:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6ce5ffd97eaafd60cc4c535f8af6b5c47d529237d23d9b9c739237625e727794
TEKSTI	0420c18471418e9b338c975776ffc220984e872adab963eaed5b3b76c5f57333
PAMJA	9e8b74c0c4bd70456aa3ff86aef28a402c17a47eb431c5a6a738cc6846180343

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72a4b4c9d1ac9997bf3fc05edf578c8f80b22b4858a95896245e095ad0d1fbd2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdf5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72a4b4c9d1ac9997bf3fc05edf578c8f80b22b4858a95896245e095ad0d1fbd2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

Edhe fundi e ka një erë... Stradner: Kremtini mund ta ndihmojë Vuçiqin me energji! Procedohen dy mjeke neurologe pas vdekjes së një 40-vjeçari, dyshohen për mjekim të fundit

Edhe fundi e ka një erë...



27 Shtator 2026, 12:40 Blog Nga Ben Andoni

Shkrimtarët e ruajnë zakonisht një shprehje, kur i pyesin për situatën ku gjendet bota dhe paradokset plot makth që po na rrethojnë. Shkrimtari Daniel Kehlman (*i përkthyer edhe në shqip nga A. Kove*) përmendte një thënie të Dürrenmatt (*autor i përkthyer nga i ndjeri A. Klos*) se një histori nuk përfundon po nuk gjeti variantin më të keq të saj, në një intervistë të tij me gazetarin e ndjerë grek, Anteos Hrisostomidhis. Më erdhi befás ndërmend kjo, kur në një panel të festivalit SINTRAK (*edicioni i parë, kuruar dhe ideuar nga përkthyesja dhe autorja Milena Selimi*) me shkrimtarin e njohur bullgar dhe filozofin Todor P. Todorov e pyeta pak ditë më parë për kohën ku po jetojmë dhe sesi e perceptonte ontologjikisht këtë kohë. Vijoi një pauzë, pastaj me kujdes duke u kthyer nga publiku i "Teatrit të Kukullave" tha diçka që të trandte: *"Duhet të kapësh fundin që të ndryshosh"*, përsëriti atë që e kisha dëgjuar dhe lexuar edhe herë tjetër. Heshti për të kapur përshtypjen e auditorit. Dhe pastaj, me sytë drejt tyre, shtoi një pyetje retorike: *"Po cili është vallë fundi?"* Përgjigjen e dha po vetë pas disa sekondash që dukeshin si orë. *"Isha duke folur për një temë në Rusi. E përsërita këtë ide dhe u mundova ta shtjelloja, duke besuar se isha brenda idesë që shprehte faktin sesi e konceptoja fundin nga ana filozofike. Në fund të aktivitetit, m'u afrua një plakë e vjetër dhe më tha: Bir, e di çfarë është fundi? Për çfarë fundi e kishe vërtetë fjalën? E ke provuar luftën. Zinë e bukës? Mbijetesën ekstreme? Sigurisht, që jo, - kishte vazhduar plaka, sepse po t'i kishe jetuar do të kuptoje se skamja, vdekja dhe fundi që t'i e percepton filozifikisht shndërrohet dikur në materie. Të duket se e ke para dhe ka një kutërbim që nuk ia gjen dot kurrë emri, sepse është e llahtarshme. Uroj të mos e provoni këtë erë, sepse do tmerrohesh...do tmerroheni të gjithë"*.

Këtë hyrje kaq të gjatë po e bëjmë për një moment, ku po kalon Shqipëria dhe ku nuk gjendet më asnjë krahasim me ngjarje tjetër në vitet e ekzistencës së saj, plot me ditë të errëta. Në çerekun e parë të shekullit XXI, askush nuk ka një përgjigje, pse Shqipëria demokratike është kaq zhgënjyese. Nuk ka shpjegime. Nuk ka as edhe një arsytim që ta shpjegojë të keqen, mosmarrjen e përgjegjësisë, pangopësinë gargantuane, babëzinë, mënyrën sesi shfrytëzohet institucioni nga njerëz, meritokracia e të cilëve është në dyshim dhe, kështu me radhë. Dilema shtohet se kjo krizë që po kalon Shqipëria i tejkalon kapacitetet tona shqisore dhe aftësitë tona të të menduarit, përveç këtu ironisë ndaj kategorive morale që tashmë nuk vihen në llogari. Jo vetëm e thjesht prej rastit të fundit skandaloz të kryeshefes së SHISH-it Vlora Hysenit dhe biznesmenit të arrestuar Agasi (*nëse rrjedhja e hetimeve është e vërtetë*); jo prej këtij parlamenti gjithmonë e më të ulët sa i përket kapaciteteve intelektuale dhe morale; propagandës boshe dhe artificialitetit; apo kotësisë; korrupsionit shtetar dhe luksit që është sot pjesë e një cinizmi që shfaqet në ekrane dhe na përplasat para fytyrës ashpër dhe plot ftohtësi. Dhe, jo sepse jemi injorantë dhe nuk kuptojmë, por sepse vetë Qenia jonë tashmë është shndërruar në kaotike dhe, po duket si rrëfim i diçkaje absurde që e përfjetojmë "normal". Po të besojmë Haidegerin (*kjo është në literaturë*), problemi është ontologjik: Qenia e sotme është tërhequr, është dobësuar. Kriza e sotme shqiptare nuk vjen prej mungesës së njohurive, është përplasje e dy mënyrave me të cilët përballet qenia dhe që nuk e gjejnë dot veten me njëra-tjetrën. Është e para ajo që është destini për të besuar institucionin, që e zhgënjën dhe e dyta lidhet me atë që beson se duhet të jetë realisht. Po të ndjekësh me kujdes arsyetimet që bëjnë në forume një pjesë e njerëzve që frymëzojnë Revolucionin e Flamingove, kupton se qenie shqiptare ka dëshirë të jashtëzakonshme për ndryshim dhe e meriton atë. Të duket sikur befás jemi kthyer në vitet e largëta '30, kur intelektualët shqiptarë e besonin ndryshimin tek të rinjtë dhe idetë që duhet të përcilleshin prej tyre.

Kriza e sotme, rastet e pafundme të korrupsionit (*incenerator, 5D, fondet e rindërtimit, AKSH e shumë e shumë të tj.*), përgjimet (*autori mendon se është e tepruar që ato të bëhen selektive dhe t'i jepen në këtë formë publikut*), puna e padobishme shpesh e administratës tregon se i ka kaluar kapacitetet tona. Shumë kolegë, të cilët mëtojnë se kanë akses në shumë burime (*edhe kjo përbën një nga çuditë e demokracisë sonë*) janë të bindur se skandale të tjera më të mëdha do të pasojnë. Kjo të trand. Kur njohuria dështon të orientohet, është shenjë se nuk po dështon njohuria jote, është Qenia jote që po shfaqet si e dobët. Sot, jemi më të dobët edhe pse perceptojmë dhe reagojmë. Demokracia është më e fortë se ne protestojmë dhe kërkojmë, anipse gjërat ndryshojnë shumë pak. Proteston Tirana dhe Prishtina, por gjërat janë aty dhe duken edhe më të zymta. Ajo që e quajtmë "demokraci" për 36 vjet në Tiranë, konfirmim dy ide. *E para* ajo që na thuhet shpesh se Demokracia është procedurë: Bëhen zgjedhje, partitë funksionojnë (!), raportet e BE-së duket se respektohen dhe evidentojnë realisht zhvillimin e vendit. Dhe, *e dyta*, demokracia si kuptim: Koncepti se ato procedura do të na bënin pjesë të Perëndimit, do të na mbronin nga cinizmi i historisë që po jetojmë. Në fakt, kemi paradoksin, në Shqipëri 97% e shqiptarëve e konsiderojnë korrupsionin si një problem mjaft serioz në vend (IRI); keqpërdorimi i pushtetit politik shihet si faktori kryesor nga 80% e shqiptarëve e kësaj gjendje (IDM); 59% e qytetarëve deklarojnë se janë të pakënaqur me mënyrën se si zhvillohet dhe funksionon demokracia në Shqipëri (IRI).

Demokracia e dobët, pra, është ajo që po jetojmë tani. Institucionet ekzistojnë, por nuk kuptojmë efikasitetin e tyre. A janë tonat? A janë të kapura? Pse nuk ka një sens për ndryshim?

E gjitha kjo, është më e rrezikshme se një fund i hidhur, sepse fundin edhe mund ta zëvendësosh. Por, demokracia jonë duket se po merr një lloj fundi, kur njerëzit pushojnë së ndjeri se e zotërojnë atë qoftë edhe në mënyrë simbolike. Shtetit të sotëm, ku Rama është gjithçka nuk i duhet më të ndalojë së foluri dhe

në fakt nuk e bën (*po e provon protesta*), por i ka bërë shqiptarët të ndjejnë se të folurit nuk e ndryshon asgjë. Kriminelët bëjnë ligjin dhe koha po tregon se janë të paprekshëm, lejet e ndërtimit i marrin të fortët dhe jo rrallë jashtë rregullave dhe se diploma jote nuk bën punë; deputetët shpesh janë biznesmenë të suksesshëm...dhe se Shqipëria po braktiset. Pareshtur.

Filozofikisht, ky është fundi i pronësisë ontologjike, do shpjegonte atë ditë profesori bullgar te “Teatri i kukullave”, dikur parlamenti i parë shqiptar. Ndoshta këtë fund nuk e kemi ndjerë ende, por era e tij është kaq e fortë dhe duket se po e sjellin dhe ndryshimet kudo që ndodhin në Evropë dhe vrundujt e lajmeve të luftën që po vinë shpesh e më shpesh. Plaka ruse e dinte prej jetës këtë mësim, por mësimet e saj “*nuk i hyjnë më në punë askujt*”. Ne po e shkatërrojmë vetë ëndrrën e bukur demokratike. Për fat të keq jo vetëm ne shqiptarët, por ngado. Era e fundit, ajo që kutërbon, me sa duket pret të na shpërfaqet një orë e më parë... Veçse, do jetë vonë. (Homo Albanicus)

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?"

19:30 Blog / 14 komente

Pse Moody's rrit vlerësimin për ekonominë e Shqipërisë?

17:00 Blog / 1 koment

[Në kohën e Super Inteligjencës, merremi me Super Budallëqe](#)

12:00 Blog / 43 komente

Pse Rinasi po konkurron aeroportet e Rumanisë dhe Bullgarisë?

08:02 Blog / 9 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.